



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 104/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së BOE “Kevin Konstruksion” shpk & “Eurogjici Security” shpk në procedurën e prokurimit “ <i>Procedurë e Hapur</i> ” me Nr. REF-46816-12-26-2019, me objekt: “ <i>Furnizim vendosje kamera sigurie për godinat e UKT sh.a</i> ” me fond limit 8,300,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
Ankimues:	BOE “Kevin Konstruksion” shpk & “Eurogjici Security” shpk Rruga “Adem Jashari”, Nd.4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake nr.5 Tiranë
Autoriteti kontraktor:	Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.3 Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.12.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-46816-12-26-2019, me objekt: “*Furnizim vendosje kamera sigurie për godinat e UKT sh.a*”, me fond limit 8,300,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 07.02.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.02.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

- Fredi Electronic 5,658,245 I skualifikuar

- | | | |
|----------------------|-----------|----------------|
| - Kevin Konstruksion | 6,073,175 | I skualifikuar |
| - Strict | 7,031,400 | I kualifikuar |
| - Real Com | 7,859,000 | I skualifikuar |
| - Ratech | 8,000,000 | I kualifikuar |

II.4. Referuar parashtrimeve në ankesë të operatorit ekonomik ankimues por edhe aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor, provohet fakti se në datën 18.02.2020 ankimuesi ka depozituar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij.

II.5. Operatori ekonomik ankimues pretendon se, në datën 21.02.2020, është njohur me aktin e trajtimit të ankesës, shkresën nr. 4079/1 prot., datë 19.02.2020, të autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 04.03.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Në datën 26.12.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-46816-12-26-2019, me objekt: “*Furnizim vendosje kamera sigurie për godinat e UKT sh.a*”, me fond limit 8,300,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

III.1.1. Në datën 07.02.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 14.02.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|----------------------|-----------|----------------|
| - Fredi Electronic | 5,658,245 | I skualifikuar |
| - Kevin Konstruksion | 6,073,175 | I skualifikuar |
| - Strict | 7,031,400 | I kualifikuar |
| - Real Com | 7,859,000 | I skualifikuar |
| - Ratech | 8,000,000 | I kualifikuar |

III.1.3. Referuar parashtrimeve në ankesë të operatorit ekonomik ankimues por edhe aktit të trajtimit të ankesës nr. 4079/1 prot., datë 19.02.2020 të operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor, provohet fakti se në datën 18.02.2020 ankimuesi ka depozituar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij.

III.1.4. Operatori ekonomik ankimues në parashtrimet në ankesë pretendon se, në datën 21.02.2020, është njohur me aktin e trajtimit të ankesës të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 4079/1 prot., datë 19.02.2020, nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.5. Në datën 04.03.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit rezulton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 18.02.2020. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu sensu* parashikohet se *Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës ndërsa ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor.*

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur

ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komsioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ezauruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Rezulton se autoriteti kontraktor, ka shqyrtuar ankesën me shkresën nr. 4079/1 prot., datë 19.02.2020 për të cilën ankimuesi pretendon se ka marrë djeni më datë 21.02.2020 nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.8. KPP gjykon se ankimuesi nuk arrin të provojë me asnjë dokument zyrtar faktin e marrjes në dorëzim të shkresës 4079/1 prot., datë 19.02.2020 më datë 21.02.2020. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Megjithatë edhe nëse e marrim të mirëqenë faktin e marrjes djeni lidhur me refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor më datë 21.02.2020 sërish ankimuesi do të ishte në kushtet e mosrespektimit të afatit të ankimimit pranë KPP-së pasi data 04.03.2020 është në tejkalim të afatit 10 ditor të parashikuar nga ligji.

III.1.9. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 04.03.2020 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve ligjore të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor e që në rastin konkret do të merret e mirëqenë data e pretenduar nga ankimuesi 21.02.2020.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Kevin Konstruksion” shpk & “Eurogjici Security” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-46816-12-26-2019, me objekt: “Furnizim vendosje kamera sigurie për godinat e UKT sh.a ”, me fond limit 8,300,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 272 Protokoli, Datë 04.03.2020.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha